

Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve 1 Qershor 2007



të drejtat në interesa

të fëmijëve



I dashuri President,

Në Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve, pranoni përhëndetjet e fëmijëve të botës me dëshirën që çdo ditë të jetë e jona si kjo e sotmja.

Të përkujtojmë se çdo i dhjeti fëmijë në botë, përkohësisht apo tërë jetën është me aftësi të kufizuara, prandaj kërkojmë pjesëmarrje efektive në shoqëri në bazë të barazisë dhe jodiskriminimit me të tjerët.

Shpresojmë që në Kosovën Tonë të Pavarur do të ndërmerren masa adekuate që edhe fëmijët me aftësi të kufizuara t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë në bazë të Konventave Ndërkombtare.

Të drejtat e fëmijëve = Të drejta tuaja

Me respekt,
Fëmijët me aftësi të kufizuara



Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve 1 Qershor 2007



të drejtat në interesa

të fëmijëve



I dashuri President,

*Gjendja e njomë psikofizike e fëmijve me aftësi të kufizuara kërkon :
rehabilitim, identifikim të hershëm, intervenim dhe shërbime të
ndryshme shëndetësore të cilat çojnë kah minimizimi dhe pengimi i
zhvillimit të mëtutjeshëm të funksioneve të kufizuara. Kemi nevojë
për shërbime efikase shëndetsore dhe sa më afër bashkësive ku
jetojmë.*

Kushtet shëndetsore = E drejtë e jonë

*Me respekt,
Fëmijtë me aftësi të kufizuara*



Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve 1 Qershor 2007



të drejtat në interesa të fëmijëve



I dashuri President,

Barierat e shumta arkitektonike sot janë realitet në Kosovë dhe pengesë serioze për lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara.

Ne, fëmijët me aftësi të kufizuara, dëshirojmë të shkojmë në shkollë, teatër, terrene sportive, të shokët, tek të afërmit, të luajmë dhe t'i gëzohemi natyrës pa kufizime, prandaj duam të inicojmë parimet "e dizajnit univerzal" i cili egziston në SHBA që nga viti 1970.

Të metat tona = E meta e shoqëris

*Me respekt,
Fëmijët me aftësi të kufizuara*



Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve 1 Qershor 2007



të drejtat në interesa të fëmijëve



I dashuri President,

Vij nga bota e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe kam një porosi për Kosovën e Pavarur : jeta e fëmijëve me të meta psikofizike dhe e familjeve të tyre në mbarë botën vetvetiu është e rëndë, prandaj, Ju lusim të na mbronni dhe lehtësoni kushtet e jetës.

Le të jetojmë së bashku 365 ditët e vitit si një Familje e lumtur sepse vetëm kështu mund t'a realizojmë kuptimin e barazisë njerëzore!

Dinjiteti ynë = Dinjiteti juaj

*Me respekt,
Fëmijët me aftësi të kufizuara*




Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve 1 Qershor 2007



të drejtat në interesa

të fëmijëve





I dashuri President,

E drejta në informim është e drejtë njerëzore. Na lehtësoni komunikimin mes veti, duke zhvilluar gjuhën e shenjave, alfabetin e Brajtit, komunikimin alternativ...

Kosova duhet të zhvillohet si shoqëri HUMANE

*Me respekt,
Fëmijët me aftësi të kufizuara*



Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve 1 Qershor 2007



të drejtat në interesa të fëmijëve



Idashuri President,

Konventën mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara e cila është hapur për nënshkrim nga 30. marsi i 2007 e të cilën deri më tani e kanë ratifikuar 92 shtete të botës, duhet ta nënshkruajë edhe Kosova pas pavarësisht të saj.

Kërkojmë mbështetje për vazhdimin dhe zhvillimin e arsimit inkluziv për fëmijët me aftësi të kufizuara.

E drejta në shkollim inkluziv

*Me respekt,
Fëmijë me aftësi të kufizuara*



Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve 1 Qershor 2007



Donator:



Organizatorët:



"Ky projekt u financua përmes grantit të zyrës së SHBA-ve në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit (ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."



**IPVQ
MINISTRIA
E SHËNDETËSISË**

Dizajnoi: Hilmnijeta Apuk, info@lpkosova.com